



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008 dhe nenit 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 17.03.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONEVE PËR VENDOSJEN E SHTATOREVE PËR
DËSHMORËT DHE VEPRIMTARIN E KOMBIT

Neni 1

MIRATOHET, Vendimi për caktimin e tri (3) lokacioneve për vendosjen e tri (3) shtatoreve për dëshmorët dhe veprimtarin e kombit si vijon:

1. Lokacioni 1 –Shtatorja e dëshmorit të kombit “Xhavit Kozhani” përcaktohet në pjesën e parcelës kadastrale në pronësi shoqërore P-71409044-01792-4, ZK Lipjan që shtrihet në rrugën me të njëjtin emër në vendin e quajtur “Varosh”.
2. Lokacioni i dytë – Shtatorja e dëshmorit të kombit “Haradin Bajrami” përcaktohet në pjesën e parcelës kadastrale në pronësi shoqërore P-71409080-00362-0 ZK Grackë e vjetër që shtrihet në rrugën me të njëjtin emër, në vendin e quajtur “Progon” ,
3. Lokacioni 3-Shtatorja e veprimtarit të kombit “Ruzhdi Shabani” përcaktohet në pjesën e parcelës kadastrale në pronësi shoqërore P-71409044-01637-0 në ZK Lipjan në vendin e quajtur “Varosh” që shtrihet në rrugën “Avdi Kelmendi”.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi

dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në webfaqen e Komunës.

15Nr. 353-15420

Lipjan, më 17. 03. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

